



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
KOMISIONI I SISTEMIT DINAMIK TË BILETAVE TË UDHËTIMIT**

Data 31.08.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje 1 (një) biletë udhëtimi me destinacion Tiranë – Athinë - Tiranë”
Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 63512000-1

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor Enti Rregullator i Energjisë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Kriteret e veçanta të kualifikimit:

1. Rezervimi i biletës, sipas destinacionit të kërkuar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Udhëzimin nr. 3 datë 18.06.2021 të Agjensisë së prokurimit Publik ”Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin e tyre me mjete elektronike”

2. Certifikata e akreditimit ose një vërtetim nga (IATA) që OE është i akredituar nga International Air Transport Association (IATA), të vlefshme.
3. Operatori Ekonomik duhet të ketë eksperiencë në këtë fushë, gjatë 3 (tre) viteve të fundit. Për plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e akreditimit IATA 3 (tre) viteve të fundit ose një vërtetim lëshuar nga IATA që deklaron gjendjen e akreditimit për 3 (tre) vitet e fundit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në pikën 4, gërma a) e nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Ky kriter është vendosur me qëllim për të provuar përshtshmërinë e OE për të kryer veprimtarinë në fushën e ofrimit të biletave të udhëtimit.

4. Operatori ekonomik me anë të një vetë deklarimi, duhet të marrë përsipër se:
- Në rast anulimesh apo vonesash nga kompanitë ajrore të fluturimit, do të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktor për riorganizimin e Itinerarit.
 - Do të angazhohet me përgjegjësi të lartë për zgjidhjen e problemeve lidhur me vonesat e fluturimeve, humbjen e bagazheve, sendeve të tjera si dhe çdo rast tjetër i paparashikueshëm

Argumentimi: Kriter i vendosur për të provuar disponibilitetin dhe gatishmërinë e OE për t'iu përgjigjur AK në çdo kohë dhe për çdo problem që mund të shfaqet pas rezervimit të biletës së udhëtimit.

Komisioni i Sistemit Dinamik të Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar